**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER AMELA MUKAJ**
**ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE KAMEZ, RR. BULEVARDI BLU, GODINA ARBEN DEDJA**
**TEL: 0692056273**

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 3459** **Nr. koleksioni: 1414**

**Kamez më 29/09/2020**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2020053940109018933

A2020053940109018933

**AMENDIM I KONTRATËS SHIT-BLERJES KUOTAVE DHE KAPITALEVE ME NR.2816 REP DHE NR.1234 KOL, DATE 02.09.2020**

Para meje Notere AMELA MUKAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANE, me zyrë në adresën Kamez, NJESIA ADMINISTRATIVE KAMEZ, RR.BULEVARDI BLU, GODINA ARBEN DEDJA, u paraqitën personalisht :

**SHITËS:**
Shoqëria "KASTRATI GROUP", regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS K21711502V, me adresë Lagjia 14, Rruga "Tiranes", Ura e Dajlanit, Durres, perfaqesuar nga Administratori Gani Kastrati, atësia Nebi, amësia Beglie, shtetas Shqiptar, lindur ne Brrut, Kukes, Shqipëri (ALB) dhe banues në TIRANE, me adresë DERVISH HIMA; Nd.2; H.1; NJESIA ADMINISTRATIVE NR.2; NJESIA BASHKIAKE NR.2; 1003; TIRANE, lindur më 15/11/1952, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftimin ID nr.031107938 dhe nr.personal F21115099P.

**BLERËS:**
Shoqëria ALESIO 2014, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L41713003M, me adresë Njësia Bashkiake Nr.11, rruga Lord Bajron, Banese private Nr.14, Tirane, perfaqesuar nga Administratori Klaudia Gjini, atësia Anton, amësia Radusha, shtetase Shqiptare, lindur në Koreta, Itali (ITA) dhe banuese në TIRANE, me adresë Rr: I. Tomini; Nd.004; NJESIA ADMINISTRATIVE NR.5; NJESIA BASHKIAKE NR.5; 1019; TIRANE, lindur më 18/11/1993, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Letërnjoftimin ID nr.030726410 dhe nr.personal J36118038S.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lire e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e këtij Amendimi të Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit me Nr. 2816 REP dhe 1234 KOL, datë 02.09.2020, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**Në Kontratën e Shitjes të kuotave të kapitalit me Nr. 2816 REP dhe 1234 KOL, datë 02.09.2020, bëhet amendimi/ndryshimi si më poshtë:**

Pika 2.1 e Nenit 2 ("ÇMIMI I BLERJES") të Kontratës, ndryshon si më poshtë vijon:

***2.1*** *Çmimi total i kësaj kontrate do të jetë* ***1, 000,000 (një milion) Euro****, nga të cilat:*

a. ***108,052 (njëqind e tetë mijë e pesëdhjetë e dy) Euro****do të jetë pagesa e blerjes së aksioneve/kapitalit;*
b. ***891,948 (tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Euro*** *do të jetë pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë që është paguar nga shoqëria KASTRATI GROUP sh.a në favor të Bashkisë Tiranë, më datë 09.07.2019;* ***si dhe***
c. *Marrja përsipër nga shoqëria "Alesio 2014" sh.p.k e detyrimit që ka shoqëria Kastrati Group sh.a (nëpërmjet shoqërisë Garden Residence Turdiu sh.p.k), që në përfundim të Fazës së III-të të ndërtimit të Kompleksit Garden Residence Turdiu, ti kalojë shoqërisë AK sh.p.k 1436 (njëmijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) m2 ndertim të kësaj Faze, përkatesisht kati i 4 i Godinës E.*

Pjese e pandashme e këtij amendimi/ndryshimi Kontrate do të jenë:

- Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "ALESIO 2014" sh.p.k;
- Vendimi i Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë "KASTRATI GROUP" sh.a;
- Vendimi Nr. A-6913/6 , datë 17.06.2019 i Bashkisë Tiranë, për miratimin e Lejës së Ndërtimit, së bashku me Autorizimin me Nr. A-6913/7, për Autorizimin për pagesën e taksës së ndikimit në infastrukturë, në vlerën 110,601,566 (njëqind e dhjetë milion e gjashtëqind e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë;
- Transaksioni i kryer nga shoqëria KASTRATI GROUP sh.a, nëpërmjet Raiffeisen Bank Albania (Njoftim Debitimi), të shumës prej 110,601,566 (njëqind e dhjetë milion e gjashtëqind e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë, për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, që e konvertuar në euro i takon vlera 891,948 (tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Euro (1 Euro=124 Lekë).

Ky amendim/ndryshim i Kontratës së Shitjes të Kuotave të Kapitalit me Nr. 2816 REP dhe 1234 KOL, datë 02.09.2020, u përpilua në 5 (pesë) kopje me fuqi të barabartë ligjore dhe duke qenë e bazuar në ligj vërtetohet prej meje noterit.

| **BLERËSI** | **SHITËSI** |
|---|---|
| **"ALESIO - 2014" SH.P.K** | **"KASTRATI GROUP" SH.A** |
| **ADMINISTRATORI** | **ADMINISTRATORI** |
| **KLAUDIA GJINI** | **GANI KASTRATI** |

**NOTERE**

**AMELA Q. MUKAJ**

**SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"ALESIO 2014" SH.P.K**

**NUIS L41713003M**

**VENDIM**
**I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE "ALESIO 2014" SH.P.K**

**Nr. 03 , datë 28 / 09 / 2020**

Sot, më datë 28 / 09 / **2020**, ora 11.00 u mblodh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **"Alesio 2014" shp.k**, e cila mbahet në ambientet e selisë së saj në adresën; Njesia Bashkiake Nr. 11, Rruga Lord Bajron, Banese private Nr. 14,, Tiranë.

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901 date. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", u mblodh Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, me përbërje si më poshtë:

- **Ortaku i Vetëm Z. Anton Gjinaj,** shtetas shqiptar, i biri i Ndues dhe Prenda, lindur më 08.04.1966 ne Kryezi dhe banues ne Tirane, mbajtes i Leternjoftimit me Nr. Personal G60408041L;

Meqenëse është i pranishem kuorumi i nevojshëm per marrjen e vendimeve të vlefshme, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës sa më poshtë vijon:

**1.** Propozimi për miratimin që shoqëria **"Alesio 2014" sh.p.k** të amendojë/ndryshojë Kontratën e Shitjes të kuotave të kapitalit me Nr. 2816 REP dhe 1234 KOL, të lidhur me shoqërinë **" Kastrati Group"** sh.a, më datë 02.09.2020 dhe konkretisht të amendojë/ndryshojë pikën 2.1, të Nenit 2 të kësaj kontrate, duke specifikuar se sa do të jetë pagesa e blerjes së aksioneve/kapitalit dhe sa do të jetë pagesa e taksës në infrastrukturë.

**2.** Propozimi që pika 2.1 e Nenit 2 ("ÇMIMI I BLERJES") të Kontratës, të amendohet/ndryshojë si më poshtë vijon:

***2.1*** *Çmimi total i kësaj kontrate do të jetë* ***1, 000,000 (një milion) Euro****, nga të cilat:*

***a)*** ***108,052 (njëqind e tetë mijë e pesëdhjetë e dy) Euro*** *do të jetë pagesa e blerjes së aksioneve/kapitalit;*

***b)*** ***891,948 (tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Euro*** *do të jetë pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë që është paguar nga shoqëria KASTRATI GROUP sh.a në favor të Bashkisë Tiranë, më datë 07.09.2019;* ***si dhe***

***c)*** *Marrja përsipër nga shoqëria "Alesio 2014" sh.p.k e detyrimit që ka shoqëria Kastrati Group sh.a (nëpërmjet shoqërisë Garden Residence Turdiu sh.p.k), që në përfundim të Fazës së III-të të ndërtimit të Kompleksit Garden Residence Turdiu, ti kalojë shoqërisë AK sh.p.k 1436 (njëmijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) m2 ndertim të kësaj Faze, përkatesisht kati i 4 i Godinës E.*

**3.** Propozimin per autorizimin e Administratores së shoqërisë "Alesio 2014" sh.p.k, Znj.Klaudia Gjini që të nënshkruajë amendimin/ndryshimin e Kontratës së Shit-Blerjes së Kuotave me shoqerine Kastrati Group sh.a dhe depozitimit të saj në institucionet përkatëse.

**Pas diskutimit dhe shqyrtimit të rendit të ditës si më sipër, Ortaku i Vetëm i shoqerise "Alesio 2014" sh.p.k ;**

**VENDOSI**

**1.** Miratimin që shoqëria **"Alesio 2014" sh.p.k** të amendojë/ndryshojë Kontratën e Shitjes të kuotave të kapitalit me Nr. 2816 REP dhe 1234 KOL, të lidhur me shoqërinë **" Kastrati Group"** sh.a, më datë 02.09.2020 dhe konkretisht të amendojë/ndryshojë pikën 2.1, të Nenit 2 të kësaj kontrate, duke specifikuar se sa do të jetë pagesa e blerjes së aksioneve/kapitalit dhe sa do të jetë pagesa e taksës në infrastrukturë.

**2.** Miratimin që pika 2.1 e Nenit 2 ("ÇMIMI I BLERJES") të Kontratës, të amendohet/ndryshojë si më poshtë vijon:

***2.1*** *Çmimi total i kësaj kontrate do të jetë* ***1, 000,000 (një milion) Euro****, nga të cilat:*

***d)*** ***108,052 (njëqind e tetë mijë e pesëdhjetë e dy) Euro*** *do të jetë pagesa e blerjes së aksioneve/kapitalit;*

***e)*** ***891,948 (tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Euro*** *do të jetë pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë që është paguar nga shoqëria KASTRATI GROUP sh.a në favor të Bashkisë Tiranë, më datë 07.09.2019;* ***si dhe***

**f)** *Marrja përsipër nga shoqëria "Alesio 2014" sh.p.k e detyrimit që ka shoqëria Kastrati Group sh.a (nëpërmjet shoqërisë Garden Residence Turdiu sh.p.k), që në përfundim të Fazës së III-të të ndërtimit të Kompleksit Garden Residence Turdiu, ti kalojë shoqërisë AK sh.p.k 1436 (njëmijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) m2 ndertim të kësaj Faze, përkatesisht kati i 4 i Godinës E.*

**3.** Miratimin per autorizimin e Administratores së shoqërisë "Alesio 2014" sh.p.k, Znj.Klaudia Gjini që të nënshkruajë amendimin/ndryshimin e Kontratës së Shit-Blerjes së Kuotave me shoqerine Kastrati Group sh.a dhe depozitimit të saj në institucionet përkatëse.

Pas ketij vendimi mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqerise **"Alesio 2014" sh.p.k,** u konsiderua e mbyllur.

**ORTAKU I VETËM**
**I SHOQERISE "ALESIO - 2014 SHPK**

**ANTON GJINAJ**

REPUBLIKA E SHQIPERISE ALESIO 2014 sh.p.k. L 41713003M TIRANE - ALBANIA

**SHOQERIA "KASTRATI GROUP" SHA**
**NIPT K21711502V**

# VENDIM I
# KESHILLIT MBIKQYRES TE SHOQERISE
# "KASTRATI GROUP" SHA

Nr.83 Datë 23 . 09 .2020

Në selinë e shoqërisë "**KASTRATI GROUP" SHA**, është mbledhur Këshilli Mbikqyrës i kësaj kompanie me pjesmarrjen e anëtareve:

1. **Z. Shefit Kastrati**
2. **Z. Hajredin Kastrati**
3. **Z. Sezar Beqaj**

## RENDI I DITES

**1.** Propozimi për miratimin që shoqëria **"Kastrati Group" sh.a** të amendojë/ndryshojë Kontratën e Shitjes të kuotave të kapitalit me Nr. 2816 REP dhe 1234 KOL, të lidhur me shoqërinë **" Alesio 2014"** sh.p.k, më datë 02.09.2020 dhe konkretisht të amendojë/ndryshojë pikën 2.1, të Nenit 2 të kësaj kontrate, duke specifikuar se sa do të jetë pagesa e blerjes së aksioneve/kapitalit dhe sa do të jetë pagesa e taksës në infrastrukturë.

**2.** Propozimi që pika 2.1 e Nenit 2 ("ÇMIMI I BLERJES") të Kontratës, të amendohet/ndryshojë si më poshtë vijon:

***2.1** Çmimi total i kësaj kontrate do të jetë **1, 000,000 (një milion) Euro**, nga të cilat:*

a) ***108,052 (njëqind e tetë mijë e pesëdhjetë e dy) Euro*** *do të jetë pagesa e blerjes së aksioneve/kapitalit;*
b) ***891,948 (tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Euro*** *do të jetë pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë që është paguar nga shoqëria KASTRATI GROUP sh.a në favor të Bashkisë Tiranë, më datë 07.09.2019;* ***si dhe***
c) *Marrja përsipër nga shoqëria "Alesio 2014" sh.p.k e detyrimit që ka shoqëria Kastrati Group sh.a (nëpërmjet shoqërisë Garden Residence Turdiu sh.p.k), që në përfundim të Fazës së III-të të ndërtimit të Kompleksit Garden Residence Turdiu, ti kalojë shoqërisë AK sh.p.k 1436 (njëmijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) m2 ndertim të kësaj Faze, përkatesisht kati i 4 i Godinës E.*

**3.** Propozimin per autorizimin e Administratorit të shoqërisë "Kastrati Group" sh.a, Z.Gani Kastrati që të nënshkruajë amendimin/ndryshimin e Kontratës së Shit-Blerjes së Kuotave me shoqerine Alesio 2014 sh.p.k dhe depozitimit të saj në institucionet përkatëse.

**Pas diskutimit dhe shqyrtimit të rendit të ditës si më sipër, Keshilli Mbikqyres i shoqerise "Kastrati Group" sh.a ;**

**<u>VENDOSI</u>**

**1.** Miratimin që shoqëria **"Kastrati Group" sh.a** të amendojë/ndryshojë Kontratën e Shitjes të kuotave të kapitalit me Nr. 2816 REP dhe 1234 KOL, të lidhur me shoqërinë « Alesio 2014' sh.p.k, më datë 02.09.2020 dhe konkretisht të amendojë/ndryshojë pikën 2.1, të Nenit 2 të kësaj kontrate, duke specifikuar se sa do të jetë pagesa e blerjes së aksioneve/kapitalit dhe sa do të jetë pagesa e taksës në infrastrukturë.

**2.** Miratimin që pika 2.1 e Nenit 2 ("ÇMIMI I BLERJES") të Kontratës, të amendohet/ndryshojë si më poshtë vijon:

***2.1*** *Çmimi total i kësaj kontrate do të jetë **1,000,000 (një milion) Euro**, nga të cilat:*

*d)* ***108,052 (njëqind e tetë mijë e pesëdhjetë e dy) Euro*** *do të jetë pagesa e blerjes së aksioneve/kapitalit;*

*e)* ***891,948 (tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) Euro*** *do të jetë pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë që është paguar nga shoqëria KASTRATI GROUP sh.a në favor të Bashkisë Tiranë, më datë 07.09.2019;* ***si dhe***

*f) Marrja përsipër nga shoqëria "Alesio 2014" sh.p.k e detyrimit që ka shoqëria Kastrati Group sh.a (nëpërmjet shoqërisë Garden Residence Turdiu sh.p.k), që në përfundim të Fazës së III-të të ndërtimit të Kompleksit Garden Residence Turdiu, ti kalojë shoqërisë AK sh.p.k 1436 (njëmijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) m2 ndertim të kësaj Faze, përkatesisht kati i 4 i Godinës E.*

**3.** Miratimin per autorizimin e Administratorit të shoqërisë "Kastrati Group" sh.a, Z.Gani Kastrati që të nënshkruajë amendimin/ndryshimin e Kontratës së Shit-Blerjes së Kuotave me shoqerine Alesio 2014 sh.p.k dhe depozitimit të saj në institucionet përkatëse.

Pas ketij vendimi mbledhja e Keshillit Mbikqyres te shoqerise **"Kastrati Group" SHA,** u konsiderua e mbyllur.

**ANETARET E KESHILLIT MBIKQYRES**

| **Shefit Kastrati** | **Hajredin Kastrati** | **Sezar Beqaj** |
|---|---|---|
| SHEFIT KASTRATI | Hajredin Kastrati | Sezar Beqaj |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KASTRATI GROUP
SHA
NIPT: K21711502V
URA E DAJLANIT, DURRËS - ALBANIA

BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA TIRANË**

**VENDIM**

**Nr. A-6913/6**

**PËR**

**Miratimin e lejes së ndërtimit për "Godinë banimi dhe shërbime 1, 7, 8, 11 dhe 12 kate, me 2 kate parkim nëntokë", në rrugën e Durrësit, Njësia Administrative NR. 7, Tiranë, në pronë të familjeve Turdiu, Konçi, dhe Zamira Molla, Suzana Çobani, Silva Kubati, Sibonez Bilbili, Shpresa Kazazi, Paqize Petrela, Nermin Basha, Muharrem Deliu, Mirjana Pustina, Majlinda Tabaku, Lejla Demneri, Hysen Balena, Gugash Balena, Genci Pustina, Fatjona Gashi, Ermira Kodra, Elda Çoçoli, Edmond Mansaku, Edmond Fagu, Artjan Mansaku, me zhvillues "GARDEN RESIDENCE TURDIU" sh.p.k. dhe subjekt ndërtues shoqëria "KASTRATI" sh.a.**

Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b"; nenin 23, pika 14; nenin 64 shkronja "a", të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; nenet 29, dhe 39 të ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.408, datë 13.05.2015 për "Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar); Vendimin e K.K.T-së Nr.1 datë 14.04.2017 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tiranë"; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015 për "Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës", (i ndryshuar); Urdhëresën e Kryetarit të Bashkisë nr. 8741, datë 21.03.2016 "Për procedurën e shqyrtimit të aplikimeve të lejes së zhvillimit/ndërtimit, deklaratë paraprake për kryerje punimesh, çertifikatë përdorimi, genplane azhornimi dhe përditësimet e infrastrukturave të tjera" ( e ndryshuar), Urdhrin nr.11987, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë "Për ngritjen e Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë" (i ndryshuar); Manualin e Procedurave dhe Organizimit të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim nr. 11987/1 datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë (i ndryshuar); Ligjin nr.22/2018 "Për strehimin social"; Planit të Detajuar Vendor të nënnjësisë strukturore 7/39, Faza I, miratuar me vendimin nr. 9097/6, datë 19.09.2013, të Kryetarit të Bashkisë dhe Planit të Detajuar Vendor të nënnjësisë strukturore 7/39, Faza II, zona A1 dhe A2, miratuar me vendimin nr. 22756/6, datë 22.07.2016, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, si dhe mbështetur në opinionin e datës 13.06.2019 të Këshillit Teknik, lidhur me shqyrtimin e kërkesës dorëzuar elektronikisht me numër aplikimi AN200320190015 dhe protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr. prot. A-6913, datë 20.03.2019, për leje ndërtimi për "Godinë banimi dhe shërbime 1, 7, 8, 11 dhe 12 kate, me 2 kate parkim nëntokë", në rrugën e Durrësit, Njësia Administrative NR. 7, Tiranë, në pronë të familjeve Turdiu, Konçi, dhe Zamira Molla, Suzana Çobani, Silva Kubati, Sibonez Bilbili, Shpresa Kazazi, Paqize Petrela, Nermin Basha, Muharrem Deliu, Mirjana Pustina, Majlinda Tabaku, Lejla Demneri, Hysen Balena, Gugash Balena, Genci Pustina, Fatjona Gashi, Ermira Kodra, Elda Çoçoli, Edmond Mansaku, Edmond Fagu, Artjan Mansaku, me zhvillues "GARDEN RESIDENCE TURDIU" sh.p.k. dhe subjekt ndërtues shoqëria"KASTRATI" sh.a.

**VENDOSA:**

1. Të miratoj leje ndërtimi për *"Godinë banimi dhe shërbime 1, 7, 8, 11 dhe 12 kate, me 2 kate parkim nëntokë", në rrugën e Durrësit, Njësia Administrative NR. 7, Tiranë, në pronë të familjeve Turdiu, Konçi, dhe Zamira Molla, Suzana Çobani, Silva Kubati, Sibonez Bilbili, Shpresa Kazazi, Paqize Petrela, Nermin Basha, Muharrem Deliu, Mirjana Pustina, Majlinda Tabaku, Lejla Demneri, Hysen*

*Balena, Gugash Balena, Genci Pustina, Fatjona Gashi, Ermira Kodra, Elda Çoçoli, Edmond Mansaku, Edmond Fagu, Artjan Mansaku, me zhvillues "GARDEN RESIDENCE TURDIU" sh.p.k. dhe subjekt ndërtues shoqëria "KASTRATI" sh.a.*, sipas planit të vendosjes së zonës së zhvillimit bashkëlidhur vendimit.

2. Afati i lejes ndërtimit është *36 muaj*, sipas grafikut të punimeve. Ky afat fillon nga data e plotësimit të formularit të lejes së ndërtimit.

3. Zhvilluesi/subjekti, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre, autorizohet të kryejë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në ***vlerën 110 601 566.4 Lekë.***

4. Formulari i lejes së ndërtimit i jepet zhvilluesit vetëm pas konfirmimit të pagesës për shlyerjen së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, dorëzuar elektronikisht, përmes llogarisë suaj në portalin e-Albania.

5. Zhvilluesi është subjekt i përcaktimeve të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social"[1], sipas aplikimit të kryer në datë 20.03.2019.

6. Zhvilluesi të marrë të gjitha masat për të gjitha përforcimet e skarpateve dhe të godinave në kufijtë e zonës së zhvillimit, në mënyrë që të mos ketë dëme të shkaktuara, qoftë edhe të përkohshme në pronat kufitare. Për çdo dëmtim apo shkarje të rrugëve dhe/ose të objekteve fqinjë, zhvilluesi do të mbajë përgjegjësi ligjore.

7. Për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike sipas projektit, të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen probleme në rrjetin publik.

8. Gjatë fazave të ndërtimit do të kryhen kontrolle dhe do të depozitohen pranë autoritetit vendor nga subjektet e licensuara në fushën e mbikqyrjes së punimeve të ndërtimit sipas fazave të mëposhtme:
   a) Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues;
   b) Piketimi i strukturës;
   c) Përfundimi i themeleve dhe kuota 0.00;
   ç) Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin;
   d) Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik;
   dh) Përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese:
   - *Autoriteti Vendor (DKZHT-ja) mund të verifikojë konformitetin e akteve të kontrollit sipas përcaktimeve të nenit 27/1 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015.*

9. Pas përfundimit të punimeve të kthehet territori rrethues në gjendjen e mëparshme, të riparohen të gjitha dëmtimet në rrugë, trotuare, etj.

10. Të gjelbërohet sheshi objekt zhvillimi dhe të mbillen pemë çdo 4 metra gjatë trotuarit të rrugës kryesore përbri pronës.

11. Të mos bëhen ndryshime nga projekti i miratuar, pa miratimin paraprak nga Bashkia e Tiranës, sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

---

[1] Neni 29, i ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", ligj i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.12.2018, përcakton se: "*1. Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme*".

12. Në rast të mosplotësimit brenda afateve të kushteve të përcaktuara në pikën 3, 4 të këtij vendimi, nga subjekti zhvillues, Kryetari i Bashkisë vendos masa të tjera të përshtatshme, deri në revokimin e vetë lejes së miratuar.

13. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

14. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

2019.06.17
14:16:25
+02'00'

**ERION VELIAJ**

Drejtor i Përgjithshëm DPPZHT: Ditjon Baboçi 2019.06.17 14:03:29 +02'00'
Drejtore e DKZHT: Frida Pashako — Frida Pashako, Digitally signed by Frida Pashako Date: 2019.06.17 13:19:05 +02'00'
Përgjegjës i ST: Enkelejda Murtaj — Enkelejda Murtaj, Digitally signed by Enkelejda Murtaj
Jurist i SSHA: Griselda Gjika — Griselda Gjika, Digitally signed by Griselda Gjika Date: 2019.06.17
Specialist i ST: Matilda Sotiri — Matilda Zazani, Digitally signed by Matilda Zazani Date: 2019.06.17



Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 228655 www.tirana.al

BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA TIRANË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

Nr.prot. A-6913/7

## AUTORIZIM

"Për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë"

Mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (i ndryshuar); ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e taksave dhe tarifave vendore" (i ndryshuar); vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015 për "Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës" (i ndryshuar); udhëzimin e KM nr.3, datë 28.12.2016 për "Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016"; Udhëzimin midis Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, nr.29, datë 30.07.2018 "Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme"; në kërkesën dorëzuar elektronikisht me numër aplikimi AN200320190015 dhe protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr. prot. A-6913, datë 20.03.2019, për leje ndërtimi për "Godinë banimi dhe shërbime 1, 7, 8, 11 dhe 12 kate, me 2 kate parkim nëntokë", në rrugën e Durrësit, Njësia Administrative NR. 7, Tiranë, në pronë të familjeve Turdiu, Konçi, dhe Zamira Molla, Suzana Çobani, Silva Kubati, Sibonez Bilbili, Shpresa Kazazi, Paqize Petrela, Nermin Basha, Muharrem Deliu, Mirjana Pustina, Majlinda Tabaku, Lejla Demneri, Hysen Balena, Gugash Balena, Genci Pustina, Fatjona Gashi, Ermira Kodra, Elda Çoçoli, Edmond Mansaku, Edmond Fagu, Artjan Mansaku, me zhvillues "GARDEN RESIDENCE TURDIU" sh.p.k. dhe subjekt ndërtues shoqëria "KASTRATI" sh.a., autorizohet të kryejë pagesën prej 8 % të vlerës së shitjes.

1. Vlera totale sipas vlerës referuese të vlerës së tregut — 1 382 519 580.0 Lekë
2. Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë 8 % — *110 601 566.4 Lekë*

**Shënim**: *Taksa e ndikimit në infrastrukturë paguhet brenda afateve të përcaktuara në ligj. Vërtetimi i kryerjes së pagesës duhet të dorëzohet elektronikisht, përmes llogarisë suaj në portalin e-Albania. Në rast të mosrespektimit të afatit ligjor, nuk do të vijohet me shqyrtimin e kërkesës suaj*

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
2019.06.17
14:03:43 +02'00'
**DITJON BABOÇI**

| | | |
|---|---|---|
| Drejtor i DKZHT: | F. Pashako | Frida Pashako — Digitally signed by Frida Pashako Date: 2019.06.17 13:19:40 +02'00' |
| Përgjegjës i S.T: | E. Murtaj | Enkelejda Murtaj — Digitally signed by Enkelejda Murtaj Date: 2019.06.17 13:13:29 +02'00' |
| Jurist i SSHA: | G. Gjika | Griselda Gjika — Digitally signed by Griselda Gjika Date: 2019.06.17 13:12:18 +02'00' |
| Specialist S.T | M. Sotiri | Matilda Zazani — Digitally signed by Matilda Zazani Date: 2019.06.17 13:07:09 +02'00' |



Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 228655 www.tirana.al

**PLANI I VENDOSJES PËR LEJE NDËRTIMI, PËR OBJEKTIN: "GODINË BANIMI DHE SHËRBIME 1, 7, 8, 11 DHE 12 KATE, ME 2 KATE PARKIM NËNTOKË" NË RRUGËN E "DURRËSIT", TIRANË.**
**PRONAR: FAMILJET TURDIU, KONÇI, DHE ZAMIRA MOLLA, SUZANA ÇOBANI, SILVA KUBATI, SIBONEZ BILBILI, SHPRESA KAZAZI, PAQIZE PETRELA, NERMIN BASHA, MUHARREM DELIU, MIRJANA PUSTINA, MAJLINDA TABAKU, LEJLA DEMNERI, HYSEN BALENA, GUGASH BALENA, GENCI PUSTINA, FATJONA GASHI, ERMIRA KODRA, ELDA ÇOÇOLI, EDMOND MANSAKU, EDMOND FAGU, ARTJAN MANSAKU**
**ZHVILLUES: "GARDEN RESIDENCE TURDIU" SH.P.K.**
**SUBJEKTI NDËRTUES: KASTRATI SH.A.**

SIPËRFAQJA E TOKËS QË ZHVILLOHET: 5533.2 M2

SIPËRFAQJA E TOKËS E ZËNË NGA STRUKTURA: 2054.6 M2

SHKALLA 1:500




# MIRATOHET

**KRYETARI I BASHKISE SE TIRANES**
2019.06.17
14:16:40 +02'00'
**ERION VELIAJ**

## TREGUESIT E ZHVILLIMIT

SIPËRFAQJA E TOKËS QË ZHVILLOHET 5533.2 M2
SIPËRFAQJA E TOKËS E ZËNË NGA STRUKTURA 2054.6 M2
KOEFICIENTI I SHFRYTËZIMIT TË TRUALLIT 37.1 %

## DISTANCAT NGA KUFIRI I PRONES:

VERIU : 7.7 m, 9.6 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 7 KAT
9.3 m, 8.8 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 8 KAT

JUGU : 10.7 m, 11.3 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 8 KAT

PERËNDIMI : 0.0 m (KALLKAN) NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 7 KAT
19.2 m, 20.2 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 8 KAT DHE11 KAT

LINDJA : 14.0 m, 15.6 m NGA KUFIRI I PRONËS PËR VOLUMIN 8 KAT

## DISTANCAT NGA STRUKTURAT EKZISTUESE:

VERIU : 10.3 m NGA STRUKTURA EKZISTUESE 1 KAT PËR VOLUMIN 7 KAT
10.7 m NGA STRUKTURA EKZISTUESE 7 KAT PËR VOLUMIN 8 KAT

## DISTANCAT NGA TRUPI I RRUGËS NË PROJEKT:

JUGU : 13.1 m NGA TRUPI I RRUGËS PËR VOLUMIN 8 KAT
LINDJA : 8.4 m NGA TRUPI I RRUGËS PËR VOLUMIN 8 KAT
16.4 m NGA TRUPI I RRUGËS PËR VOLUMIN 1 KAT

**SKEMA E VENDOSJES SE ZONES SE ZHVILLIMIT**

SHKALLA 1:2000



**POZICIONI KADASTRAL** Z.Kadastrale 8210, Nr.i pasurise 1/616
SHKALLA 1:2000



| | | | |
|---|---|---|---|
